



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

PRISHTINË, 16 DHJETOR 2010
NR. REF.: RK 74 /10

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI 07/10

Parashtruesi

Komuna e Klinës

**Vlerësimi i kushtetutshmërisë
të vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, Nr. 112/08,
të datës 5 qershor 2009**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është Komuna e Klinës përfaqësuar nga Xhavit Dauti, avokat nga Klina.

Vendimi i sfiduar

2. Parashtruesi sfidon vendimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës (më tutje: KPMK) Nr. 112/08 të datës 5 qershor 2009, që iu ka dërguar parashtruesit më 16 qershor 2009.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi sfidon vendimin e KPMK-së në bazë të Nenit 113.4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (më tutje: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Neni 113.4 i Kushtetutës, Neni 22 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i datës 16 dhjetor 2008 (më tutje: Ligji) dhe Neni 54 (b) i Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (më tutje: Rregullorja e Punës).

Procedura para Gjykatës

5. Më 27 janar 2010, parashtruesi dorëzoi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (më tutje: Gjykata).
6. Më 24 mars 2010, KPMK-ja u njoftua lidhur me kërkesën, e njëjta u përgjigj më 13 korrik 2010. KPMK-ja vendimin e tyre mori duke u bazuar në Nenin 11.1 të Rregullores 2008/12 që e autorizon KPMK-në t'i shqyrtojë ankesat e ushtruara nga shërbyesit civil dhe se kërkesa e parashtruesit është e pabazuar.
7. Më 13 dhjetor 2010, pas shqyrtimit të raportit të Gjyqtares raportuese, Iliriana Islami, Kolegji shqyrtues, i përbërë nga gjyqtarët Almiro Rodrigues (kryesuesi), Zëvendëskryetari Kadri Kryeziu dhe gjyqtarja Gjyljeta Mushkolaj, ia rekomanduan atë Gjykatës së plotë.

Përmbledhje e fakteve

8. Më 31 janar 2008, ushtruesi i detyrës së Drejtorit të Drejtorisë së Administratës dhe Personelit të Komunës së Klinës, përmes njoftimit nr. 02-118-481/08, të datës 31 janar 2008, informoi shefin e sektorit të Inspektoratit në Drejtorinë për Urbanizëm dhe Shërbime Publike (më tutje: SHI) për shkëputje të marrëdhënies së punës prej datës 29 shkurt 2008. Si arsye ishte riorganizimi i ekzekutivit komunal në bazë të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2007/30 për Vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës, pozita, në të cilën ai shërbente që nga data 1 korrik 2005, duhej të shuhej, edhe pse kontrata e tij mbi marrëdhënien e punës ishte zgjatur nga data 2 korrik 2007 deri më 30 qershor 2010.
9. Më 26 shkurt 2008, duke u bazuar në Nenin 35 të UA nr. 2003/02, për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/36 për Shërbimin Civil të Kosovës, hapit 5 të UA nr. MSHP/DASHC 2003/02 për procedurat e kontratave, ushtruesi i detyrës së Drejtorit të Drejtorisë të Administratës dhe Personelit të Komunës së Klinës konfirmoi aktvendimin e SHI për përfundim të punësimit.
10. I pakënaqur me aktvendimin, SHI paraqiti një ankesë (Ankesa nr. 01-118-865/08 më 5 mars 2008) pranë Komisionit Komunal për Ankesa të Komunës së Klinës.

11. Më 8 prill 2008, Komisioni për Ankesa refuzoi ankesën si të pabazuar juridikisht duke theksuar se Komuna e Klinës kishte vendosur për të riorganizuar drejtoritë komunale më 14 janar 2008, ku Drejtoria e Inspeksionit Komunal ishte njëra prej tyre dhe që ndërlidhej me shuarjen e pozitës së SHI.
12. Më 5 qershor 2009, komisioni i KPMK-së, të cilit SHI ia kishte drejtuar ankesën, e aprovoi ankesën, duke shfuqizuar vendimin e Komisionit për Ankesa.
13. Për më tepër, komisioni i KPMK-së udhëzoi Komunën e Klinës që ti respektoj të gjitha të drejtat e SHI sipas kontratës për marrëdhënien e punës dhe në rast të pamundësisë, të veprohet në përputhje me Nenin 11.1 të Urdhërësës Administrative 2003/2 për zbatimin e Rregullores 2001/36 për Shërbimin Civil në Kosovë, i cili nen përcakton që në vend të shkarkimit arbitrar, nëpunësit civil, duhet të sistemohen në një pozitë tjetër që përputhet me përgatitjet dhe aftësitë e tyre profesionale.
14. Gjithashtu, KPMK-ja kërkoi nga Komuna e Klinës që të njoftohet lidhur me ndërmarrjen e masave sipas vendimit në fjalë, gjithsesi, në rast mosveprimi sipas këtij vendimi, KPMK-ja do të ndërmarrë masat e parapara me Nenin 11.4 të Rregullores 2008/12 për ndryshimin e Rregullores 2001/36 për Shërbimin Civil të Kosovës, i cili përcakton se KPMK-ja ia paraqet rastin Kuvendit, i cili ia përcjellë raportin e KPMK-së dhe Kryeministrit të Kosovës.

Pretendimet e parashtruesit

15. Parashtruesi i kërkesës, pretendon se KPMK-ja përmes vendimit nr. 112/08 të datës 5 qershor 2009 ka shkelur Kushtetutën, sepse vendimi i tillë sipas parashtruesit nuk përputhet me dispozitat përkatëse të Rregullores 2001/36 mbi Shërbimin Civil të Kosovës dhe Nenin 35 të Urdhërësës Administrative për zbatimin e Rregullores 2001/36 të Ligjit mbi Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe hapin 5 të Udhëzimit Administrativ nr. MSHP/DASHC 2003/02 për procedurat e kontratave.
16. Për më tepër, parashtruesi pretendon se vendimi i KPMK-së i bazuar në Nenin 11 pika 11.1 të Rregullores nr. 2008/12 për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2001/36 për Shërbimin Civil të Kosovës, Neni 35 i Urdhërësës Administrative nr. 2003/2 për zbatimin e Rregullores 2001/36 mbi Shërbimin Civil të Kosovës, paraqet vetëm autorizimin e palës për paraqitje të ankesës tek KPMK-ja, e jo edhe për të vendosur lidhur me rikthimin e nëpunësit civil në pozitën e mëparshme.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

17. Në mënyrë që kërkesa të jetë e pranueshme, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë se a i ka përmbushur parashtruesi i Kërkesës të gjitha kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë, Ligj dhe me Rregullore të Punës së Gjykatës Kushtetuese.
18. Gjykata vëren se parashtruesi parashtroi kërkesën sipas Nenit 113.4 të Kushtetutës, i cili parasheh:

"Komuna është e autorizuar të kontestojë kushtetutshmërinë e ligjeve ose të akteve të Qeverisë, të cilat cenojnë përgjegjësitë komunale ose zvogëlojnë të hyrat e komunës, në rast se komuna përkatëse është prekur nga ai ligj ose akt".

19. Me Nenin 101.2 të Kushtetutës përcaktohet se KPMK-ja është organ i pavarur.

20. Sipas Rregullores së UNMIK-ut, nr. 2008/12 për ndryshimin e Rregullores nr. 2001/36 të datës 27 shkurt 2008, në Nenin 7.1 është paraparë:

“Me anë të kësaj rregulloreje formohet një Këshill i Pavarur Mbikëqyrës i Kosovës (më tej në tekst: Këshilli)”.

21. Me Nenin 7.2 të Rregullores së UNMIK-ut, nr. 2008/12 për ndryshimin e Rregullores nr. 2001/36 të datës 27 shkurt 2008, është paraparë:

“Këshilli është njësi e mëvetësishme që i raporton në mënyrë të drejtpërdrejt Kuvendit të Kosovës. Kuvendi i Kosovës ia përcjell Kryeministrit të gjitha raportet e Këshillit. Të gjitha raportet e Këshillit janë dokumente publike.”

22. Faktin që KPMK-ja është institucion i pavarur e vërteton edhe Neni 8.1 i kësaj rregullore i cili përcakton se: *“Këshilli përbëhet prej shtatë (7) anëtarëve që emërohen nga Kuvendi i Kosovës në bazë të procedurave të hapura dhe transparente.”*, që do të thotë se anëtarët e këshillit as që propozohen nga Qeveria.

23. Për më tepër, KPMK-ja në procedurën e vlerësimit të respektimit të parimeve udhëheqëse të shërbimit civil në përputhje me Nenin 13 të rregullores së lartpërmendur ka bërë vizita kontrolluese në zyrën e Kryeministrit, në Presidencë, Administratën e Kuvendit, dhe ky fakt e vërteton pavarësinë e KPMK-së si dhe e vërteton faktin se vendimet e KPMK-së nuk janë akte të Qeverisë por janë akte të një organi të pavarur (*shih Raportin Vjetor të Punës së KPMK-së*).

24. Për më tepër, me Ligjin nr. 03/L-192 për KPMK-në, fushë veprimtaria e KPMK-së është përcaktuar me ligj të veçantë.

25. Prandaj, pretendimi i parashtruesit se shkelja ka ndodhur sipas Nenit 113.4, në rastin konkret është e papajtueshme me Kushtetutën për arsye se kompetencat e Komunës, sipas nenit të lartcekur për të paraqitur një kërkesë në Gjykatën Kushtetuese, janë të limituara në këto çështje: ligjet ose aktet e Qeverisë të cilat cenojnë përgjegjësitë e Komunës ose të hyrat financiare të Komunës, të cilat, për ndryshe, parashihen me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale dhe me Kartën Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale. Gjykata me këtë rast thekson se vendimet e KPMK-së, në rastin konkret, nuk i cenojnë këto përgjegjësi sepse janë në kuadër të kompetencave që ky organ i pavarur i ka me Kushtetutë dhe ligj dhe bëjnë pjesë në përgjegjësitë e kontrollit të autorizuar në limitet kushtetuese të vetëqeverisjes lokale. Duke marr parasysh të dhënat e cekura është e qartë që kërkesa e Komunës ne përmbajtjen e saj është e papajtueshme me Kushtetutën sipas parimit *ratione materiae*.

26. Për më tepër, Neni 11.6 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2008/12 për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2001/36 për Shërbimin Civil të Kosovës përcakton se:

“Vendimi i Këshillit paraqet vendimin administrativ të formës së prerë, që i nënshtrohet shqyrtimit gjyqësor në përputhje me ligjin në fuqi”.

27. Nga dokumentacioni i paraqitur në lëndë, parashtruesi nuk ka dëshmuar se ka bërë ankesë në përputhje me udhëzimin juridik. Në përputhje me Nenin 31 (5) të Ligjit mbi gjykatat e rregullta (Gazeta Zyrtare e Krahinës Autonome Socialiste të Kosovës, nr. 46/76), vendimet përfundimtare administrative shqyrtohen në Gjykatën Supreme në procedurën e konfliktit administrativ.

28. Edhe nëse nisemi nga supozimi që parashtuesi i kërkesës ka pasur kompetencë lëndore për të paraqitur këtë kërkesë, Gjykata konsideron se në përputhje me Nenin 113.7 lidhur me Nenin 21.4 të Kushtetutës, të cilët parashohin:

“113.7 Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

“21.4 Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme”.

Parashtuesi i kërkesës nuk ka dëshmuar që i ka shteruar të gjitha mjetet juridike që ekzistojnë sipas ligjit të zbatueshëm.

29. Arsyetimi mbi kërkesën e shterimit është që t'iu ofrojnë autoriteteve në fjalë, duke përfshirë gjykatat, mundësinë për të parandaluar ose për të korrigjuar shkeljen e supozuar të Kushtetutës. Rregulli bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës do të sigurojë mjete efektive për shkeljen e të drejtave kushtetuese. Ky është një aspekt i rëndësishëm i karakterit subsidiar të Kushtetutës. (shihni, Aktvendimi për Papranueshmëri: AAB-RIINVEST L.L.C., Prishtine vs Qeverisë së Republikës së Kosovës, KI-41/09 të datës 21 janar 2010, dhe shihni mutatis mutandis, ECHR, Selmouni v.France, no. 25803/94, vendim i datës 28 korrik 1999).

30. Për këto arsye, kërkesa është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në bazë të Nenit 113.7 të Kushtetutës, Nenit 20 të Ligjit, si dhe Nenit 54 (b) të Rregullores së Punës, në seancën e datës 16 dhjetor 2010, njëzëri:

VENDOS

- I. **TË REFUZOJË** kërkesën si të papranueshme.
- II. Ky vendim do t'i komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me Nenin 20 (4) të ligjit.
- III. Ky vendimi hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja Raportuese

Iliriana Islami, d.v.



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. Dr. Enver Hasani, d.v.